



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE VLORË

NOTER FLORA XH. ZOTO
ADRESA 29 NENTORI, DERVISH
HEKALI, P.4 KATESH PRANE
GJYKATES
TEL: 695225897

VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 696

Fier më 24/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"




V2021062240037521963

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
NOTER FLORA XH. ZOTO



V2021062240037521963



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 24.02.2021, para meje Notere FLORA XH. ZOTO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, 29 NENTORI, DERVISH HEKALI, P.4 KATESH PRANE GJYKATES, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Era Çuko, atësia Bajram, amësia Gjyljana, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë Rrapi Shkurti Raj.2 Fier; Nd. 1; H. 0; Ap. 0; Fier; Fier; 9305; Fier, lindur më 25/03/1994, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032160965 dhe nr. personal J45325098I, .

NËNSHKRUES:

Pamela Gremi, atësia Zenel, amësia Yllka, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Patos, me adresë Beline; Nd. 105; H. 0; Ap. 0; Zharëz; Belinë; 9317; Patos, lindur më 11/08/1995, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032250037 dhe nr. personal J55811019V, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqiten dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “Statutin e shoqerise Medical-Sal”, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

FLORA XH. ZOTO

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Medikal-Sal “SHPK

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Medikal-Sal “SHPK**.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **“Medikal-Sal “shpk**, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me përgjegjësi te kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqeria”).

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **“Medikal-Sal “shpk**, eshte një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Fier ,Sheqishte , zona kadastrale 3361 , numer pasurie 94/22 .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hapë zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqeria **“Medikal-Sal ”shpk.**, ka per objekt kryerjen e cdo aktiviteti te lejuar me ligj dhe/ ose pjesemarrje ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem që mund te kryeje një shoqeri me përgjegjësi te kufizuar ne baze te legjisacionit shqiptar ne fuqi dhe,

ne vecanti :

Tregetim me shumice dhe pakice , import eksport me shumice dhe pakice solucionesh higenike ,materiale dentare ,

Prodhim dhe tregtim me shumice e pakice e materialeve te ndertimit, produkteve qeramike, dekorative, shfrytezim dhe perpunimi i produkteve minerare te grupit I-IV

Tregtim me shumice dhe pakice i mallrave industriale, makinerive, pajisjeve dhe pjese kembimi te ndryshme ,import eksport i mallrave , makinerive pajisjeve dhe materiale ndertimi, te

pajisjeve hidraulike dhe elektrike, tregtim i pajisjeve te ndryshme elektroshtepiake , elektronike, hidrosanitare, qeramike dhe te artizanatit .

Import eksport me shumce dhe pakice te sistemeve te kondicionim ventimilit , te sistemeve te ngrohjes ,kaldajave etj .

Prodhim dhe tregetim te artikujve te ndryshem mobilerie, dyer, dritare, artikuj duralumini, tregetim paisje zyre, kanceleri, paisje ventilimi dhe kondicionimi,kundra zjarrit.

Pastrim Kimik .

Ajensi udhetimesh turistike. Ajensi imobiliare. Ajensi shitje biletash te transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar.

Import eksport dhe tregetim me shumice e pakice te automjeteve te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to.

Import, eksport, tregetim te pajisjeve dixhitale, radiotelevizive, informatike, komunikacion, industriale, elektrike.

Import eksport, tregetim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, artikuj buqesor dhe blegtore, paisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, konfeksione, metrazhe, lende kimike.

Grumbullim, perpunim, eksport dhe tregetim me shumice e pakice te bimeve medicinale, produkteve dhe nenprodukteve buqesore, blegtore dhe pyjore.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 lekë dhe eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem " i shoqerise :

Ortaku Themelues: Era Cuko , zoterues i 1 (nje) kuote , me vlore te per gjithshme 50 Leke, qe perbene 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortaku Themelues :Pamela Gremi , zoterues i 1 (nje) kuote , me vlore te per gjithshme 50 Leke, qe perbene 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretave deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pas rregjistrimit te shoqerise ne QKB.

Neni 7



Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet mënshkimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së Ortakut te Vetem të thirrur për të marrë vendim rrith këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombëtare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të rapporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procédimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - c) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator.

Administrator i shoqerise eshte Znj .Era Cuko dhe Pamela Gremi te cilet i do te ushtrojne funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 13 Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise në Qendren Kombëtare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 14 Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rrëth shperndarës se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 Eksperet

Eksperi ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të



ushtuara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dle per ate per kontrollet periodike te ushtuara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezze ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondevi ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem te shoquerise.

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoquerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim te ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprmtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshtë njoftuar pezullimi i veprmtarisë në përputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjt nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoquerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoperi ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim te rasteve kur eshtë nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Ortakeve .

Nëse Asambleja e Ortakeve nuk merr një vendim per emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipëri te drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit te tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvëse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht te drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund te autorizojnë njërin prej tyre te kryejë veprime te një kategorie te posaçme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te tretëve, ne përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes se ortakut dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshtë mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqërisë, mbledhja e kredive te

paarkëtuara dhe e kontributave të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjera, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsë ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asambleese se Ortakeve , duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatesisht dispozita e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare përfundit e detyrimet e kësaj.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja përfundimtar.

marrëdhëniet ndërinjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me reportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shnderrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare
Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plotë me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe, dhe pasi iu lexua ortakut , nenshkruehet me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

ASAMBLEJA E ORTAKeve

Era Cuko

ERA CUKO


Pamela Gremi

Pamela Gremi
